

Manuali i Etikës dhe Integritetit Policor

Tekst për trajnimin mbi etikën në polici

Përgatiti

Arjan Dyrmishi

IDM, Tiranë 2106



Kingdom of the Netherlands



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Shënim: Ky punim u realizua në kuadër të Projektit “Indeksi i integritetit policor” i cili u mbështet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës në kuadër të Programit Matra për shtetin ligjor. Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë holandeze.

Parathënie

Manuali mbi etikën dhe integritetin policor është një instrument pune që i bashkohet dhe vjen në ndihmë përpjekjeve të gjithanshme policisë së shtetit të orientuara drejt ndërtimit të një policie me etikë dhe integritet. Kjo mbështetje që vjen nga një partner i rëndësishëm i shoqërisë civile, si Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, është në përputhje të plotë me prioritetet e Policisë së Shtetit për forcimin e kulturës së integritetit dhe trajnimin mbi etikën si mjet për forcimin e integritetit në radhët e policisë, elemente këto të një rëndësie të veçantë dhe pjesë e objektivave të Policisë së Shtetit në dokumentet e saj strategjike, në bazën ligjore dhe rregullat organizative.

Miratimi i kuadrit ligjor është një gur themeli në rrugën e ndërtimit të një organizate policore të udhëhequr nga etika dhe kultura e integritetit, por aktualizimi i tyre dhe arritja e objektivave të synuar kërkojnë një kombinim përqasjesh dhe mjetesh, ku një peshë të rëndësishme zënë pikërisht kultivimi i një sistemi të duhur vlerash dhe principesh etike dhe të integritetit, që në formimin bazë ashtu edhe në atë në vazhdim, të çdo punonjësi policie. Në këtë kuadër ndërtimi i infrastrukturës së trajnimit mbi etikën dhe integritetin policor dhe kryerja e trajnimeve të efektshme janë me rëndësi të madhe.

Ky manual reference i shërben pikërisht ndërtimit dhe konsolidimit të rrugës drejt kapaciteteve dhe praktikave etike dhe me integritet në policinë e shtetit. Ndonëse manuali është konceptuar që së pari t'i shërbejë tri audiencave – menaxherëve/drejtuesve të policisë, trajnuesve (të edukimit bazë dhe atij në vazhdim), si dhe çdo punonjësi policie, në këndvështrimin tim, vlera e tij shkon edhe më tej. I shkruar me një gjuhë të kuptueshme edhe për audiencë më të gjera, ai mund të kthehet edhe në një mjet komunikimi dhe përafrimi drejt një kuptueshmërie të përbashkët të policisë së shtetit dhe komunitetit (qytetarëve) për çka duhet të presin dhe të pranojnë si etike dhe me integritet apo refuzojnë dhe raportojnë si praktika jo etike dhe pa integritet të policëve të shtetit.

Haki Çako

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë

Tabela e lëndës

Ç'është manuali	6
Çfarë synon trainimi i etikës	7
Ç'është etika	8
Përkufizimi i etikës	
Përse nevojitet etika	
Situatat etike	
Parimet e vendimmarrjes etike	
Verifikimi paraprak i një vendimi etik	
Etika në zbatimin e ligjit	
Etika, integriteti dhe korrupsioni	11
Llojet e sjelljes jo-etike	
Policimi etik	
Vendimmarrja etike	
Vlerat dhe kultura	

Trainimi i etikës për punonjësit e policisë	22
Organizimi i trajnimeve të etikës	
Përmbajtja e trajnimeve	
Elementë që duhet të kihen parasysh kur hartohet një program trajnimi etike	
Kushtetuta si mjet për trajnimin mbi etikën	
Trajnimi mbi etikën duhet të jetë sa më real	
Trainimi nëpërmjet identifikimit dhe zgjidhjes së dilemave etike	34
Probleme, justifikime dhe mënyra alternative të menduarit për zgjidhjen e dilemave etike	44
Përfundime	50
Referenca e leximit mëtejshëm	52

Ç'është manuali

Manuali i etikës dhe integritetit policor është hartuar për të mbështetur strukturat e trainimit dhe menaxhimit në Policinë e Shtetit për ndërtimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit të etikës.

Fokusi tek policimi etik përbën aspektin kryesor të strategjive antikorrupsion. Thelbi etik i policimit bazohet në parimet kryesore të jetës publike, siç janë: ligjshmëria, përgjegjshmëria, barazia, paanshmëria, transparencja, integriteti, efikasiteti, drejtësia, të cilat së bashku me llogaridhënien, proporcionalitetin në përdorimin e forcës dhe mbrojtjen e interesave publike dhe të individit reflektohen edhe në rregullat e etikës dhe sjelljes në Policinë e Shtetit.

Hartimi i këtij manuali lindi si nevojë në kuadrin e përpjekjeve të shoqërisë civile për të mbështetur Policinë e Shtetit në forcimin e kulturës së integritetit dhe trajnimin e etikës si mjet për forcimin e integritetit.

Forcimi i integritetit dhe udhëheqja e policimit nga vlerat dhe etika janë përcaktuar si objektiva të Policisë së Shtetit në dokumentet e saj strategjike si dhe në bazën ligjore dhe rregullat organizative. Por miratimi i kuadrit ligjor është vetëm një nga hapat në rrugën e ndërtimit të një organizate policore të udhëhequr nga etika dhe kultura e integritetit. Policimi etik nënkupton ndryshimin e normave dhe rutinës ekzistuese. Për të arritur këtë shndërrim lind si domosdoshmëri ndërtimi i kapaciteteve për menaxhimin e ndryshimit. Në këtë kuadër ndërtimi i infrastrukturës së trainimit të etikës dhe kryerja e trajnimeve të efektshme janë me rëndësi të madhe.

Nisur nga premiset e mësipërme, ky manual është hartuar me qëllimin që t'iu shërbejë trajnuesve të policisë për të hartuar dhe zbatuar programe të trajnimit të etikës.

Në thelb manuali trajton se si duhet të trajnohen punonjësit e një organizate policore me integritet dhe të udhëhequr nga etika. Për këtë arsye manuali u shërben dhe drejtuesve dhe punonjësve të policisë, por edhe të rinjve që synojnë të hyjnë në radhët e kësaj organizate në të ardhmen.

Çfarë synon trainimi i etikës

Trainimi i etikës ka dy qëllime kryesore. Në radhë të parë trajnimi synon t'u vijë në ndihmë punonjësve të policisë për të njohur etikën, vlerat e policimit dhe përjasjet e ndryshme ndaj etikës. Së dyti, trainimi i etikës ka për qëllim të krijojë mjedisin e përshtatshëm dhe kushtet që u duhen oficerëve të policisë për të mësuar se si të zgjidhin dilemat etike me të cilat pritet të përballen gjatë ushtrimit të detyrës.

Trainimi i etikës duhet t'u shërbejë punonjësve të policisë që të mësojnë të marrin vendimet e duhura duke menduar për pasojat e vendimeve të gabuara dhe duke marrë përgjegjësinë për ato vendime.

Edhe pse kodi i etikës parashikon detyrimin e çdo punonjës policie për të përvetësuar dhe zbatuar parimet dhe normat e etikës policore, përvetësimi i etikës në mënyrë të zbatueshme mund të realizohet vetëm nëpërmjet trajnimeve, të cilat i vendosin oficerët e policisë në situata praktike e sa më reale.

Do të ishte e gabuar që punonjësit e policisë të ndëshkoheshin për vendimet e tyre nëse ata nuk njohin më parë pasojat e vendimeve që mund të marrin. Programet e trajnimit të etikës janë ndihmë për punonjësit e policisë duke u bërë të qartë atyre pasojat e vendimeve të gabuara. Po ashtu, ato ofrojnë udhëzime që punonjësit e policisë jo vetëm të veprojnë në mënyrë etike por dhe të mendojnë në mënyrë etike në vendimet që marrin si gjatë orarit të punës ashtu dhe jashtë saj.

Krijimi i infrastrukturës së nevojshme të etikës dhe hartimi i programeve trajnuese të ndërtuara mbi metoda të të mësuarit praktik nëpërmjet vendosjes së punonjësit e policisë në situata praktike reale i ndihmojnë ata në forcimin e vendimmarrjes etike.

Ç'është Etika

Përkufizimi i etikës

Etika është një tërësi parimesh mbi sjelljen e drejtë, një sistem vlerash morale, rregullat dhe standardet që udhëheqin sjelljen e një personi apo të anëtarëve të një organizate.

Përse nevojitet etika

Punonjësit e policisë në mënyrë të vazhdueshme gjenden në situata ku u duhet të marrin vendime të natyrës etike. Për këtë është e rëndësishme që ata të dinë se cila është situata etike dhe pasojat e vendimit të marrë në këtë situatë.

Situatat etike

Situata etike merr parasysh kontekstin specifik të një veprimi. Sado të detajuara të jenë rregullat e parashikuara, oficerët e policisë do të gjenden, gjithsesi, në situata në të cilat do të duhet të marrin vendime (ose e shprehur ndryshe, në situata etike).

Parimet e vendimmarrjes etike

- Të menduarit në bazë të rregullave
- Të menduarit në bazë të detyrës
- Të menduarit në bazë të pasojave të vendimmarrjes
- Të menduarit në bazë të kujdesit për të dhënë shërbimin

Verifikimi paraprak i një vendimi etik

- A është vendim i ligjshëm?
- A i shkel ky vendim rregullat, ligjet, dhe Kushtetutën?
- A është vendim i drejtë dhe i barabartë për të gjithë?
- A do të miratohej ky vendim nga eprorët dhe publiku?

Etika në zbatimin e ligjit

- Njerëzit nuk lindin me etikë, ata bëhen të tillë.
- Të gjithë duhet të trajnohen për situatat etike.
- Në situatat etike, e gabuara apo e drejta varen nga situata. Çdo rast është i veçantë dhe meriton zgjidhje të veçantë.
- Të gjithë duhet të bëjnë përpjekje për të vepruar në përputhje me etikën, ligjin dhe rregulloret e policisë.
- Vendimmarrja etike rrit respektin dhe besimin tek policia

Njohja dhe përvetësimi i etikës janë të domosdoshme dhe parakusht për zbatimin e etikës. Nuk mund të pritët që punonjësti e policisë të zbatojnë diçka të cilën nuk e njohin më parë. Trajnimi t i etikës bën të mundur që punonjësit e policisë të njohin etikën, të marrin vendimet e duhura dhe të kuptojnë dhe mendojnë se përse i marrin ato vendime dhe jo të tjera.

Trajnimi i etikës duhet të pasqyrojë parimet dhe vlerat e parashikuara në kodine e etikës dhe t'u japë punonjësve të policisë mjetet e duhura për të interpretuar dhe menaxhuar situatat etike. Për këto arsye, trajnimi i etikës duhet të jetë një pjesë integrale dhe e pandashme e infrastrukturës së etikës (për më shumë mbi infrastrukturën e etikës shiko "Pakoja e Instrumenteve mbi Integritetin e Policisë").

Rregullorja e Policisë së Shtetit dhe Etika

Rregullorja e Policisë së Shtetit përmban elementet e etikës policore. Përgjithësisht, Rregullorja ka karakter njohës dhe normativ mbi etikën. Ajo përcakton parimet, standardet dhe normat që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të oficerët të policisë si gjatë shërbimit ashtu edhe jashtë tij.

Rregullorja parashikon edhe detyrimin e çdo punonjësi policie për zbatimin e parimeve, standardeve dhe normave të Etikës Policore si dhe përgjegjësitë për shkeljen e tyre.

Megjithatë, rregullorja nuk tregon se ç'është etika apo se cilat janë instrumentet për përvetësimin e saj.



Etika, integriteti dhe korrupsioni

Etika dhe integriteti nënkuptojnë gatishmërinë dhe preokupimin për të realizuar diçka pozitive dhe në shërbim të njerëzve. Korrupsioni, në të kundërt, shihet si shembje e vlerave, normave dhe parimeve etike që udhëheqin jetën e një organizate dhe pjesëtarëve të saj. Origjina e fjalës korrupsion vjen nga latinishtja ‘corruptus’ që do të thotë ‘i prishur’ dhe ‘corrumpere’ që do të thotë ‘shkatërroj’.

Grupi i Ekspertëve të Interpolit për Korrupsionin (GEIK) e përkufizon korrupsionin si ‘çdo veprim ose mosveprim nga individë ose organizata, publike ose private, në kundërshtim me ligjin ose besimin për qëllime përfitimi’.

Prandaj, korrupsioni shihet si i gabuar dhe si një kërcënim ndaj demokracisë, mirëqeverisjes, sigurisë, ligjit, mbrojtjes së qytetarëve e pronës.

Diskutimi mbi etikën dhe korrupsionin përqendrohet në çështjen se si një organizatë mund të sillet dhe veprojë në mënyrë etike ndërkohë që ajo përbëhet nga njerëz të cilët nuk udhëhiqen nga standardet më të larta morale dhe personale.

Për shkak të fokusit gjithnjë në rritje ndaj etikës dhe mjedisit të policimit, i cili në vitet e fundit ka ardhur duke u bërë gjithnjë e më kompleks dhe sfidues, diskutimi mbi etikën dhe korrupsionin policor është bërë edhe më i mprehtë.

Për pasojë edhe integrimi i etikës dhe forcimi i integritetit kanë marrë rëndësi të veçantë dhe shihen si të pandashme nga policimi.

Ndryshe nga korrupsionin i kryer nga zyrtarë të tjerë të shtetit, korrupsioni policor ka prirje të shihet se ka pasoja më të rënda për dy arsye:

Së pari, shërbimi policor është ajo agjenci e shtetit nga e cila publiku pret që të kontrollojë sjelljen e të tjerëve, përfshirë atë të zyrtarëve të tjerë të shtetit. Kështu që, nëse humbet besimi tek policia atëherë bëhet më e vështirë për publikun të besojë që ndonjë institucion tjetër mund të zbatojë ligjin dhe ruajë rendin publik.

Karakteristikat që duhet të kenë punonjësit me integritet.

PËRGJEGJËSIA

synimi për të bërë gjënë e duhur, të kuptuarit qartë se çfarë është e drejtë dhe të jesh plotësisht i vetëdijshëm për alternativat e tjera që mund të ekzistojnë; marrja e përgjegjësisë në vend të justifikimeve për gabimet apo gjykimin e dobët

DREJTËSIA

dhënia e masës së duhur ndaj një qytetari të veçantë edhe kur ajo mund të bjerë ndesh me atë çka parashikohet si detyrim në mënyrën më të rreptë

NDERSHMËRIA INTELEKTU

mosdija e diçkaje dhe të qenurit i përunjur dhe për të pasur guxim të mjaftueshme për ta pranuar

PUNONJËS M

MATURIA

aftësia për të dalluar mes virtyteve konfliktuale dhe të vendosë për të marrë veprimin më të mirë

BESIMI

besnikëria në marrëdhëniet mes punonjësve të policisë dhe qytetarëve, kolegëve, dhe eprorëve

FSHIRJE E INTERESAVE VETJAKE

pa këtë, punonjësit mund të shfrytëzojnë autoritetin e tyre për qëllime vetiake

KURAJA

mesatarja mes frikës dhe guximit të tepruar

JALE

E INTEGRITET

Së dyti, një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit të policisë kryhet larg syrit të publikut të gjerë dhe përfshin në një pjesë të madhe veprimtarinë kundër kriminelëve apo keqbërësve. Kjo distancë e bën punën e policisë më pak transparente sesa aktivitetet e tjera të shtetit. Prandaj, që policia të jetë e pranueshme për publikun duhet që ky i fundit të ketë më shumë besim tek shërbimi policor sesa tek agjencitë e tjera të shtetit.

Llojet e sjelljes jo-etike

Korrupsioni është vetëm një formë e sjelljes jo-etike. Punonjësit e policisë zakonisht kryejnë tri lloj shkeljesh: vepër penale, shkelje të disiplinës dhe shkelje të etikës.

Sjellja jo-etike, ndodh kur një punonjës policie përballet me një konflikt ndërmjet rregullave dhe vlerave. Për shembull, nëse një punonjës më i vjetër policie shkakton një aksident me automjetin e punës dhe i kërkon kolegut më të ri që të mos e raportojë, çfarë duhet të bëjë ai: të zbatojë rregullat dhe ta denoncojë aksidentin, apo të respektojë vlerat e besnikërisë dhe solidaritetit ndaj kolegëve dhe, kështu, të heshtë?

Nëse vendos të mos e raportojë shkeljen ai është sjellë në mënyrë jo-etike, pasi ka shkelur vlerat e organizatës të parashikuara në kodin e etikës. Edhe pse të dy nuk kanë kryer ndonjë krim, mosveprimi përbën një akt jo-etik. Nëse shkelja do të ishte më e rëndë, atëherë është më e vështirë të bëhet dallimi mes korrupsionit, krimit dhe sjelljes jo-etike, pasi ato mbivendosen dhe në varësi të rrethanave mund të përkufizohen në mënyrë subjektive.

Vlerat e organizatës duhet të zbatohen, ndaj është e nevojshme që ato të materializohen dhe konkretizohen nëpërmjet kodeve, siç janë udhëzimet, kodi i etikës, rregullorja e disiplinës, etj.

Me gjithë vështirësinë praktike për t'i dalluar nga njëri tjetri, kodi i disiplinës dhe kodi i etikës dallojnë nga natyra e tyre. Kodi i disiplinës ka natyrë reaguese, ndërsa kodi i etikës ka natyrë parandaluese.

Është e nevojshme që punonjësit e policisë të njohin ndryshimin ndërmjet kodit të etikës dhe kodit të disiplinës si dhe qëllimet specifike që kanë, në mënyrë që t'i zbatojnë më korrektësi.

Qasja parandaluese synon t'u japë punonjësve të policisë udhëzimet

se si të marrin vendimet dhe pyetjet që duhet t'i bëjnë vetes në lidhje me integritetin. Kjo qasje, në thelb, synon veçanërisht të ushqejë dhe forcojë sjelljen etike.

Qëllimi i qasjes reaguese, nga ana tjetër, është që të ndreqë shkeljet e integritetit. Kjo kryhet nëpërmjet rregullave të rrepta të disiplinës dhe procedurave që rregullojnë veprimtarinë e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

Në rregullat për disiplinën, të përcaktuara në Rregulloren e Policisë së Shtetit parashikohen llojet e sjelljes, të cilat në thelb nuk përbëjnë sjellje kriminale, por që konsiderohen të papranueshme, si dhe masat ndëshkimore përkatëse.

Kodi i etikës, nga ana tjetër, parashikon sjelljen që pritet prej punonjësve të policisë dhe që ndryshe nga kodi i disiplinës ka natyrë orientuese dhe frymëzuese.

Hartimi dhe miratimi i këtyre kodeve dhe rregulloreve janë pjesë e planit për të ndërtuar një shërbim policor me etikë, por ky plan nuk mund të zbatohet pa një komunikim dhe trajnim efektiv si dhe pa një vlerësim të vazhdueshëm të ndikimit mbi organizatën.

Policimi etik

Policia është institucion me rëndësi jetike për një demokraci. Nëpërmjet zbatimit të ligjit policia bën të mundur që asnjë individ apo grup individësh të mos i imponohet rendit publik dhe të dëmtojnë interesat e qytetarëve. Nëpërmjet angazhimit me interesat e qytetarëve, aftësisë së tyre për të mbajtur nën kontroll kriminalitetin dhe aftësisë për ta bërë këtë në përputhje me ligjin, policia bën që demokracia të mbijetojë.

Por rregullat për zbatimin e ligjit mund të jenë kontradiktore. Punonjësve të policisë iu duhet të ndalojnë, arrestojnë dhe, nëse nevojitet, edhe neutralizojnë fizikisht apo si mundësi të fundit eliminojnë fizikisht qytetarë, të cilët përfshihen në veprimtari të paligjshme. Rregullat janë të shumta dhe komplekse dhe ka paqartësi dhe mosdakordësi se si mund të vlerësohet nëse policia i ka zbatuar me korrektësi këto ligje dhe rregulla.

Si do të vlerësohet policia, për shembull, në një operacion kundër narkotikëve, kur një informator sinjalizon se një trafikant i dyshuar ka

drogë në shtëpinë e tij? A duhet që policia të kontrollojë shtëpinë pa pasur mandat gjykatë apo të rrezikojë që trafikanti i dyshuar të mund të largohet së bashku me drogën, ndërkohë që niset procedura për marrjen e mandatit nga gjykata? Po sikur të mos ketë drogë dhe kur policia të hyjë në banesë i dyshuari të ndeshet me armë me policët dhe të shkaktohen viktima?

Dilema të tilla janë të shpeshta në punën policore dhe vija ndarëse ndërmjet një veprimi të ligjshëm dhe një veprimi të paligjshëm është shumë e hollë.

Njohja e rregullave dhe ligjeve janë të rëndësishme por është vendimmarrja etike ajo që i ndihmon punonjësit e policisë të bëjnë zgjedhjen e duhur.

Vendimmarrja etike

Punonjësi i policisë është mishërim i vullnetshëm i moralitetit të shtetit. Ky i fundit është i kodifikuar në sistemin e ligjeve dhe normave dhe vihet në lëvizje nëpërmjet veprimeve të oficerëve të policisë, të cilët duke kryer punën e tyre vënë në jetë moralitetin e shtetit dhe bëjnë të mundur që të zbatohen ligjet dhe sigurohet rendi publik.

Prandaj është shumë e rëndësishme që punonjësit e policisë ta kenë të qartë se cila sjellje është e drejtë dhe cila e gabuar, sepse çdo vendim që ata marrin reflekton vlerat që shteti mishëron.



Dilema etike me të cilën ballafaqohen punonjësit e policisë lidhet me përshtatjen e kompetencave dhe autoritetit që u jep shteti me mënyrën se si ata zbatojnë ligjin në emër të shtetit.



Shumë punonjës të policisë mendojnë se ligjet e shtetit që synojnë të rregullojnë sjelljen e tyre edhe mund të anashkalohen, nëse kjo bëhet për qëllime të mira. Të tjerë mendojnë se shteti nuk është mjaftueshmërisht mirënjohës për punën e tyre apo nuk kujdeset mjaftueshëm për ta. Ndaj, ata i lejojnë vetes të përdorin kompetencat dhe autoritetin që u jep shteti për të plotësuar nevojat e tyre profesionale apo personale.

Disa hapa drejt
vendimmarrjes etike

1



Mendo për dilemat etike dhe dallo në mënyrë sa më objektive elementët përbërës

2



Shqyrto alternativat

3



Vendos për alternativën më etike

4



Shqyrto mundësitë e zbatimit të alternativës

5



Shqyrto pasojat e vendimit

Njohja dhe përvetësimi i etikës i mësojnë punonjësit e policisë se si t'i mposhtin shtysat dhe presionin që vënë në lëvizje këtë forcë devijuese dhe për të marrë vendime që udhëhiqen nga vlerat.

Punonjësit e policisë janë krijesa të ligjit dhe ata nuk duhet të kenë asnjë mëdyshje se ligji dhe rregullat duhen respektuar dhe zbatuar gjithmonë.

Moraliteti, kontributi për shoqërinë, siguria e publikut, mbrojtja dhe shërbimi janë rezultate të vendimmarrjes etike, ndërsa organizata e policisë dhe ligji janë mjetet për arritjen e tyre.

Vendimi konsiderohet etik kur krijon besim dhe kur tregon respekt, përgjegjshmëri, ndershmëri, përkujdesje si dhe është në përputhje me vlerat e qytetarisë së mirë. Por vendimi duhet të jetë edhe efektiv, pasi duhet të arrijë atë që synohet. Prandaj, vendimet e duhura janë gjithmonë edhe etike edhe të efektshme.

Disa pyetje që duhen shtruar
kur marrim një vendim etik



A shpie vendimi i marrë në
krijimin e një rregulli?

A është vendimi i ligjshëm?

A është i sigurt?

A është në përputhje me
interesin publik?

A është në të mirën e
 shumicës?

A është vendimi proporcional
dhe i ndershëm?

A do më bëjë të ndihem mirë ?

Nëse shkon keq, si mund ta
mbroj veten?

A do ta bëja këtë përpara
njerëzve të mi më të afërt?

Vlerat dhe Kultura

Kultura në përgjithësi është tërësia e besimeve kolektive, vlerave, qëndrimeve dhe njohurive të një shoqërie që shfaqet në formën e sjelljes sipas një modeli të përbashkët.

Kultura policore në veçanti është rezultat i vlerave të sjella në organizatën policore nga mjedisi më i gjerë shoqëror nga i cili vijnë punonjësit e policisë, të cilat kondensohen dhe përqendrohen në mjedisin më të ngushtë të punës policore për të formuar atë që quhet kulturë profesionale e policisë.

Kultura policore përfshin vlerat dhe standardet që ndikojnë në modelin e sjelljes dhe praktikën e punës, parë nga mënyra se si aplikohen nga punonjësit e policisë’.



Kultura profesionale policore ka aspektet e saj pozitive dhe negative.

Kultura profesionale luan rol pozitiv në punën e policisë për një sërë arsyesh. Ajo u jep mundësinë punonjësve të rinj të mësojnë më shpejt mbi punën policore, ushqen ndjenjën e përgjegjshmërisë dhe të përgjegjësisë dhe krijon ndjenjën e identitetit dhe solidaritetit. Kultura profesionale krijon kornizën që bën të mundur përshtatjen me mjedisin e paparashikuar të punës si dhe mund të japë mbështetje morale e të krijojë frymën e skuadrës brenda organizatës, të cilat janë të nevojshme për një rol të efektshëm të policisë në përmbushjen e detyrës. Ajo mund t'i japë një punonjësi policie orientimin praktik për të ushtruar detyrën si dhe ndihmon në përvetësimin e një sërë praktikash pune, të cilat nuk mësohen në shkollë.

Por kultura policore ka dhe aspekte negative, të cilat rezultojnë, po ashtu, prej natyrës së punës së policisë. Një nga tiparet negative të kulturës policore është heshtja. Kultura e heshtjes shfaqet në forma të thjeshta, kur përdoret për mbulimin e gabimeve të sinqerta të kolegëve, por mund të përdoret edhe me qëllim fshehjen e akteve që bien ndesh me ligjet dhe rregullat.

Tipari i dytë negativ është perceptimi nga punonjësit e policisë se

disa aspekte të papërshtatshme të sjelljes janë të pranueshme, pasi i shërbejnë realizimit të detyrës dhe misionit. Në këto rrethana, punonjësit e policisë mendojnë se mund të anashkalojnë ose edhe mund të thyjnë ligjin duke e relativizuar në konceptin e etikës. Për shembull, në këmbim të informacionit, i cili mund t'i ndihmojë në gjetjen, arrestimin ose dënimin e dikujt që dyshohet se ka kryer një krim më të rëndë, ata mund të bëjnë ujdi me një kriminel duke premtuar lehtësira për të cilat kanë kompetencë apo duke bërë sikur nuk shohin që ai ka shkelur ligjin.

Tipar tjetër negativ i kulturës policore është anashkalimi apo deformimi në zbatimin e ligjeve nga punonjësit e policisë me qëllim për të përshpejtuar vendosjen e drejtësisë. Kjo shpie në veprime si, manipulimi i provave apo dhe përdrimi i dhunës si formë ndëshkimi ndaj të dyshuarve të cilët janë shkelës të shpeshtë të ligjit por për shkeljet që ata kryejnë nuk parashikohen dënime të rënda dhe policët vendosin ta japin vetë drejtësinë.

Organizatat policore me integritet janë të ndërgjegjshme për këto tipare të kulturës policore dhe krijojnë kushtet për të forcuar aspektet pozitive të kulturës profesionale dhe për të minimizuar aspektet negative.

Për këtë arsye, kultura profesionale është një faktor i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe në të njëjtën kohë është treguese e rëndësisë që një organizatë policore i kushton integritetit dhe etikës.

Trainimi i etikës për Punonjësit e Policisë

Kodi i etikës ka vlerë të rëndësishme simbolike, sepse tregon angazhimin e organizatës policore ndaj etikës. Por, shpesh kodet e etikës e vendosin fokusin tek ligjshmëria, ndërkohë që një organizatë policore duhet të synojë njëkohësisht edhe për standarde më të larta sjelljeje edhe se vetë ligji, ç'ka i bën të dallueshëm punonjësit e policisë nga qytetarët e tjerë.

Një nga sfidat më të mëdha që lidhen me integritetin policor është trajnimi i punonjësve të policisë mbi etikën dhe fusha të caktuara të saj në mënyrë që ata të kuptojnë plotësisht së çfarë synon të arrijë kodi i etikës.

Përfitimet nga zbatimi i një kodi etike janë të shumta, pasi u kujton punonjësve të policisë se çfarë pritet prej tyre dhe shërben për të njehsuar njohjen e problemeve të caktuara e lehtësuar komunikimin ndërmjet punonjësve të policisë.

Megjithatë, kodi i etikës nuk e motivon punonjësën e policisë në mënyrë të vetvetishme që ai të silllet në mënyrë etike. Kodi vetëm sa jep drejtimet e duhura për të orientuar ata që duan të sillen në mënyrë etike dhe që duan të marrin vendime etike.

Për këtë arsye trajnimi i punonjësve të policisë në etikë, si për kodin ashtu edhe për zbatimin e tij, është jetik për të rritur motivimin e tyre dhe për ta bërë etikën pjesë të kulturës organizative.

Misioni i policimit mund t'u besohet vetëm atyre që dinë të marrin vendimet e duhura, kuptojnë pasojat e vendimeve që marrin dhe respektojnë integritetin.

Trajnimi i etikës për punonjësit e policisë nuk duhet të konsistojë vetëm në të treguarit se çfarë duhet të bëjnë dhe se si duhet të sillen ata.

Trajnimi i etikës i duhet të hartohet në mënyrë që të ndihmojë punonjësit e policisë që të:

1



dallojnë menjëherë një problem apo dilemë etike

2



identifikojnë alternativat e ndryshme për të zgjidhur një çështje të caktuar

3



bëjnë një zgjedhje të arsyeshme dhe sa më etike të alternativës së zgjedhur

4



veprojnë menjëherë në bazë të zgjedhjes së bërë

5



pranojnë përgjegjësinë e rezultatit që do të dalë nga zgjedhja e bërë

Nuk mjafton që punonjësit e policisë të mendojnë në mënyrë etike. Ata duhet që dhe të veprojnë në mënyrë etike.

Trajnimi i etikës ofron instrumentet për trajtimin e problemeve etike, por punonjësit e policisë duhet të kenë dhe guximin për të vepruar.

Trajtimi i një situatë të caktuar përmban dy komponentë: reagimin dhe veprimin. Ligjet dhe rregulloret fokusohen tek veprimi, që nënkupton se për sa kohë që veprimi i kryer është në përputhje me ligjin arsyet që shpiten në kryerjen e atij veprimi nuk kanë rëndësi.

Etika, ndryshe nga ligjet, shqyrton jo vetëm veprimin por edhe motivet e veprimit. Të bësh gjënë e duhur për motive të gabuara nuk është etike. Prandaj, shërbimi i mirë policor nuk mund të shmangë analizimin e motiveve të veprimeve të punonjësve të policisë.

Për këtë, trajnimi i etikës për punonjësit e policisë duhet të përfshijë si të vepruarit ashtu edhe të menduarit me etikë, në mënyrë që ato të bëhen pjesë përbërëse e cilësive individuale të punonjësit të policisë dhe të kulturës organizative.



Pyetje mbi trainimin e etikës

A ka ndërtuar apo a ka në plan të ndërtojë Policia e Shtetit një infrastrukturë të përshtatshme për përvetësimin dhe zbatimin efikas të etikës?

A janë trainimet e etikës të bazuara në dilemat etike me të cilat ballafaqohen punonjësit e policisë dhe të ndërtuara në mënyrë që t'i ndihmojnë ata të veprojnë dhe të mendojnë në mënyrë etike në vendimet që marrin?

Cilat janë vështirësitë që mund të hasen për forcimin e kulturës së integritetit dhe udhëheqjen e punonjësve të policisë nga etika dhe vlerat në zbatimin e ligjit?

A ekzistojnë dhe funksionojnë në mënyrë efektive institucionet dhe organizatat që janë përgjegjëse për monitorimin e jashtëm të zbatimit të etikës?

Organizimi i trainimeve të etikës

Qëllimi kryesor i trainimit të etikës është parandalimi i korrupsionit dhe ofrimi i shërbimeve cilësore. Trajnimi i etikës është një praktikë e përhapur në vendet demokratike, pavarësisht nivelit të korrupsionit. Megjithatë, në vendet me nivel të ulët korrupsioni dhe me shërbime publike më të zhvilluara trainimi i etikës është më cilësor. Nga ana tjetër, programet e trajnimit të etikës janë më pak të zhvilluara në vendet me korrupsion të lartë. Kjo ka bërë që të rritet interesi për trajnimin e etikës dhe integritetit sidomos në vendet candidate për në BE.

Meqenëse nevojat për trajnime të etikës janë të mëdha është e rëndësishme që në radhë të parë të vlerësohen nevojat për trajnim. Për të përcaktuar sektorët prioritarë mund të përdoren vlerësimet e riskut apo sondazhet që tregojnë shkallën e ekspozimit apo nivelin e korrupsionit. Megjithatë kurset e trajnimit mund të organizohen me tematikë të larmishme duke përfshirë e përzgjedhur edhe pjesëmarrës vullnetarë.

Për të pasur trajnim me cilësi, aspekt tjetër i rëndësishëm janë trajnerët e etikës. Zakonisht trajnerët mund të jenë staf i përhershëm ose kombinim i trajnerëve të përhershëm me ata të jashtëm vendas apo të huaj.



REKOMANDIME TË OECD MBI TRAJNIMIN E ETIKËS.

Trajnimi i etikës duhet parë si pjesë e strategjisë antikorrupsion.

Ky trajnim, i zbatuar së bashku me mjetet e tjera antikorrupsion, është mjet i rëndësishëm për forcimin e etikës dhe për parandalimin e korrupsionit.

Trajnimi për grupe të veçanta.

Në rast të kufizimeve në burime dhe buxhete, është e rëndësishme të prioritarizohet trajnimi për ato grupe që kanë nevojë të ngutshme apo më të madhe për trajnim.

Trajnimi i etikës duhet të jetë sa më praktik.

Për ta bërë trajnimin sa më pak formal dhe sa më të orientuar drejt praktikës është e rëndësishme të përdoren metoda sa më moderne trajnimit, të cilat kombinojnë leksionet teorike dhe përshtaten me ushtrime praktike e seminare.

Trajnimi për rregullat, vlerat dhe zonat 'gri'.

Për të siguruar ndryshimin në qëndrimin e pjesëmarrësve të trajnimit ka rëndësi të kombinohet trajnimi i rregullave të etikës me ato për vlerat etike.

Përmbajtja e trajnimeve

Trainimet e etikës mund të bazohen në përjasje zbatuese, që fokusohet tek zbatimi i ligjeve dhe rregullave ose në atë të vlerave apo duke i përdorur të dyja përjasjet. Megjithatë, trajnimet mund të fokusohen edhe në të ashtuquajturat zona gri, të cilat nuk janë të rregulluara me ligj, siç janë konflikti ndërmjet rregullave dhe traditës ose konflikte më specifike që lindin në sektorë të caktuar.

Ligjet the rregullat e përfshira në trajnimin e etikës	Vlerat e trajtuara në trajnimin e etikës
Kushtetuta	Ligjshmëria
Kuadri ligjor për Policinë e Shtetit	Përgjegjshmëria
Ligji për Konfliktin e Interesave	Transparenca
Kuadri ligjor për anti korrupsionin	Paanësia
Legjislacioni për informacionin e klasifikuar	Integriteti
Legjislacioni të drejtën e informimit publik	Efiçenca
Kodi penal dhe i procedurës penale	Barazia
Kodi civil dhe Kodi i Familjes	Drejtësia
Rregullorja e Policisë së Shtetit	Llogaridhënia
	Proporcionaliteti në përdorimin e forcës
	Mbrojtja e interesave publike

Elementë që duhet të kihen parasysh për hartimin e një programi trajnimi etike

1. QËLLIMI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT. Elementi i parë që duhet të kihet parasysh është qëllimi i programit të trajnimit. Në mënyrë që trajnimi të jetë i suksesshëm pjesëmarrësit duhet të kuptojnë qëllimin e tij. Trajnimi i etikës duhet t’u japë punonjësve të policisë instrumentet e nevojshëm për t’i ndihmuar ata të mendojnë dhe veprojnë me etikë si në jetën profesionale ashtu edhe në atë personale. Këto instrumente janë:

- Ndërgjegjësimi për çështje të etikës
- Dhënia e njohurive për procesin e vendimmarrjes për të zgjidhur çështjet
- Kultivimi i angazhimit dhe kurajës për të vepruar me etikë
- Krijimi i pritshmërisë së padiskutueshme për marrjen e përgjegjësisë së plotë për çdo veprim të kryer

2. VLERA E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT. Trajnimi i etikës duhet të synojë shtimin e vlerave të organizatës policore. Për këtë arsye trainimi i etikës duhet parë si kontribut në inventarin e organizatës dhe një investim të cilin policia do ta përdorë për t’i shtuar vlerën edhe komunitetit nëpërmjet sjelljes etike dhe të ndershme të punonjësve të saj.

3. KONTRIBUTI NË FORCIMI E INTEGRITETIT. Programi i trajnimit duhet të inkurajojë dhe kontribuojë në forcimi e integritetit. Trainimi i etikës duhet t’i nxisë punonjësit e policisë për t’u bërë njerëz me integritet të lartë dhe integriteti t’i karakterizojë jo vetëm në momente të caktuara por gjatë gjithë jetës profesionale dhe personale. Integriteti duhet të jetë cilësi profesionale dhe personale, sepse detyrimi i vetvetes për të luajtur role të ndryshme në situata të ndryshme dëmton shëndetin emocional të punonjësve të policisë dhe jeta profesionale e personale plotësojnë njëra-tjetrën.

4. NJOHJA DHE USHTRIMI I GJYKIMIT. Programi i trajnimit duhet të njohë dhe përfshijë ushtrimin e gjykimit. Trainimi i etikës duhet të njohë dhe japë parimet e ushtrimit të gjykimit. Mohimi i faktit se punonjësit

e policisë gjykojnë në mënyrë rutinore është i pasaktë. Gjykimi është thelbësor dhe nuk mund të eliminohet nga ushtrimi i profesionit të policit. Kjo është arsyeja që punonjësit e policisë duhet të ushtrohen për të gjykuar në mënyrë etike. Kur gjykimi bëhet në mënyrën e duhur zbatimi i ligjeve bëhet më i drejtë.

5. PAKËSIMI I RREZIQEVE. Programi i trajnimit duhet të kontribuojnë në pakësimin e rreziqeve për individin dhe organizatën. Trainimi i etikës duhet parë edhe si menaxhim risku. Qëllimi kryesor i menaxhimit të riskut është parandalimi ose zvogëlimi i dëmeve ndaj njerëzve, pronës, reputacionit dhe aseteve të tjera të organizatës. Trainimi i etikës fokusohet në rëndësinë e të menduarit përpara veprimit dhe zhvillon kontrollin e impulseve, veçanërisht në situata vështirësie apo tunduese.

6. PËRMIRËSIMI I PERFORMANCËS. Programi i trajnimit duhet të nxisë dhe presë përmirësimin e performancës. Trainimi i etikës në vetvete nuk nisët nga synimi për të realizuar një performance minimale apo të mjaftueshme por synon një performancë të shkëlqyer. Rregulloret policore në përgjithësi janë të orientuara drejt performancës bazë dhe shpesh përmbajtja e tyre përcaktohet nga reagimi ndaj dështimeve të ndryshme.

7. MEKANIZMAT LLOGARIDHËNËS. Programi i trajnimit duhet të përfshijë krijimin e mekanizmave shtesë të llogaridhënies, të cilët nxisin sjelljen etike. Programet që nxisin llogaridhënien dhe inkurajojnë përgjegjshmërinë, të tillë si sistemet e parandalimit dhe hetimit të brendshëm, janë plotësuese për përpjekjet për trajnimin e etikës. Vendimmarrja etike presupozon alternativa, zgjedhje dhe pasoja. Punonjësit e policisë, të cilët përballen me një situatë që kërkon marrjen e një vendimi etik, shqyrtojnë alternativa të ndryshme, vendos duke u bazuar mbi to, zbaton vendimin dhe përjeton pasojat. Megjithëse të padëshiruara, rastet kur veprimi i keq është i vetëdijshëm janë po ashtu të mundshme. Për këtë arsye, mekanizmat efektive të llogaridhënies janë shtysa të rëndësishme drejt marrjes së një vendimi etik.



Kurrikula e përbashkët e etikës policore e Kolegjit Evropian të Policisë

Kolegji Evropian i Policisë ka hartuar një kurrikulë të përbashkët të Etikës Policore dhe korrupsionit për policimin etik dhe anti-korrupsionin.

Kurrikula ka për qëllim të:

1. Zhvillojë vetëdijen për rolin e policisë në një shoqëri demokratike;
2. Rrisë dhe përmirësojë njohuritë në lidhje me etikën policore dhe nevojën për parandalimin e korrupsionit;
3. Demonstrtojë se të gjithë kanë një përgjegjësi për të vepruar në mënyrë etike;
4. Forcojë dëshirën për të sillen në mënyrë etike dhe aftësinë për tu sjellë në mënyrë korrekte nën presion apo në situata të vështira;
5. Mësojë se si të reagojë ndaj sjelljes jo-etike dhe korruptive;
6. Zhvillojë vetëdijen ndaj rreziqeve në punën e përditshme të policisë;
7. Garantojë një klimë etike (kjo vlen më shumë për drejtuesit);
8. Zbatojë sjelljen etike në punën e përditshme të policisë;
9. Nxisë respektimin e standardeve të përbashkëta evropiane të policimit;
10. Forcojë dhe përmirësojë profesionalizmin.

Kurrikula fokusohet tek njohuritë, qëndrimet dhe aftësitë e punonjësve të policisë.


Ajo është e ndarë katër seksione:

1. Roli i policisë në një shoqëri demokratike;
2. Pozita e etikës në një organizatë policore dhe në punën e përditshme të policisë;
3. Menaxhimi i etikës policore dhe parandalimi i korrupsionit;
4. Menaxhimi i rrezikut në fushën e etikës policore dhe parandalimin e korrupsionit.

Për secilën çështje kurrikula ka një hyrje të qartë, përshkrimin e kompetencave të nevojshme për të trajtuar temën me sukses si dhe sugjerime metodologjike.

Kurrikula synon:

- Zyrtarët e lartë të policisë (me trajnimin kryesor dhe atë të mëtejshëm të vazhdueshëm);
- Zyrtarët e rangut të mesme të policisë (me trajnimin kryesor dhe atë të mëtejshëm);
- Punonjësit e policisë në funksione të veçanta (p.sh. policia e qarkullimit rrugor, hetimi penal, policia kufitare);
- Instruktorët dhe trajnerët në institucionet trajnuese të policisë;
- Punonjësit e rinj të policisë.



Kushtetuta si mjet për i trajnimin e etikës

Profesioni i policisë evoluon dhe legjislacioni dhe normat që synojnë rregullimin e veprimtarisë policore ndryshojnë vazhdimisht.

Teksa policimi po hyn me shpejtësi në një epokë të re, ku kërkesa e llogarisë për punonjësve të policisë bazohet në kombinimin e ligjeve me teknologjinë, si telefonat celularë, kamerat e mbikëqyrjes në ambientet policore, kamerat trupore apo aplikacionet që i bëjnë të mundur qytetarëve të raportojnë në kohë reale, është e rëndësishme që punonjësit e policisë të njohin Kushtetutën dhe të udhëhiqen prej saj.

Efektiviteti i punës së policisë gjithnjë e më tepër po varet nga marrëdhëniet me qytetarët dhe komunitetin, kështu që është thelbësore që punonjësit e policisë të njohin dhe respektojnë të drejtat themelore të qytetarëve. Dhe sa më shumë që thellohen raportet polici-komunitet dhe sa më shumë të zbatohet shteti ligjor, aq më shumë shtohet rreziku që policia të përballet me raste të sjelljes jo kushtetuese.

Kushtetuta është dokument që mishëron moralin e shtetit. Në të njëjtën kohë, ajo përbën një dokument praktik në punën e policisë. Ndaj, përfshirja e Kushtetutës si pjesë përbërëse e trajnimit të etikës është hap i rëndësishëm për forcimin e integritetit policor.

Kur punonjësit e policisë sillen si të ishin mbi ligjin, apo të imunizuar prej tij, ata rrezikojnë të përfshihen në akte jo kushtetuese dhe të ngjallin ndjenjën e mosbesimit tek komuniteti.

Vetë përkufizimi i integritetit si “prirja punonjësve të policisë për t’i rezistuar tundimit për të abuzuar me të drejtat dhe privilegjet e profesionit” do të thotë respektim i Kushtetutës dhe rritje e vlerës së profesionit dhe organizatës policore. Prandaj, hedhja e themeleve të sjelljes etike të punonjësve të policisë fillon me njohjen dhe zbatimin e Kushtetutës. Jo rastësisht formula e betimit të punonjësve të rinj që hyjnë në Policinë e Shtetit i referohet në radhë të parë zbatimit të Kushtetutës.

Formula e betimit të punonjësve të Policisë së Shtetit

Unë, betohem që besnikërisht do të kryej detyrat e mia, do të zbatoj Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë me ndershmëri dhe paanshmëri gjatë gjithë kohës. BETOHEM”.



Njohja dhe respektimi nga punonjësit e policisë i të drejtave themelore të parashikuara në Kushtetutë është i rëndësishëm edhe për të zvogëluar mundësinë e dëmeve financiare që mund t'i shkaktohen të ardhurave të shtetit nga humbja prej padive për shkelje të këtyre të drejtave.

Neni 44 parashikon se “Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.

Edhe kur punonjës të policisë që kanë shkelur të drejtat e shtetasve mund të ndëshkohen, dëmi për organizatën e policisë do të mbetet, pasi do të ndikojë në prishjen e imazhit të saj në publik. Prandaj, policia duhet të bëjë pjesë të kulturës së saj profesionale angazhimin për respektimin e Kushtetutës. Trajnimi i të gjitha niveleve të policisë me standardet e Kushtetutës është një nga gurët e themelit drejt arritjes së qëllimeve të larta që duhet të realizojë policia.

Njohja e Kushtetutës i udhëheq dhe ndihmon punonjësit e policisë në proceset e përditshme të vendimmarrjes dhe gjykimin si dhe i shton vlerën llogaridhënies profesionale. Me gjithë përfshirjen e teknologjisë për të rritur llogaridhënien, asnjëherë nuk do të jetë e mundur që të monitorohet çdo detaj dhe aspekt i veprimtarisë së çdo punonjësi të policisë në të gjitha skajet e vendit. Prandaj, trainimi i etikës është i nevojshëm për çdo punonjës policie si një mjet që u shërben atyre për të kontrolluar vetveten.

Rekrutimi punonjësve cilësorë, dhënia e trajnimit të duhur, kontrolli i efektshëm dhe zbatimi rigoroz i ligjeve i bazuar në njohjen e Kushtetutës kanë rëndësi të madhe për hedhjen e bazave për zbatimin me efektivitet të ligjit dhe për krijimin e marrëdhënie pozitive me komunitetin.

Procesi i forcimit të integritetit të organizatës është i pandarë nga prirja e shtimit të numrit të punonjësve të policisë, të cilët tregojnë se i njohin dhe i zbatojnë me etikë rregullat dhe në radhë të parë njohin dhe zbatojnë Kushtetutën si dokument moral dhe praktik.



Disa nene nga Kreu II i Kushtetutës, “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, me zbatimin e të cilave policia ndeshet në punën e përditshme

Neni 18. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

Neni 21. Jeta e personit mbrohet me ligj.

Neni 25. Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor poshtërues.

Neni 27. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Neni 30. Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 32. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 36. Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara.

Neni 37. Paprekshmëria e banesës është e garantuar. Kontrollat e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj. Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjanuar një rrezik që i kanoset sigurimit publik.

Neni 44. Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Trainimi i etikës duhet të jetë sa më real

Trainimi i etikës duhet të jetë intensiv nga përmbajtja dhe duhet të prekë e jo të anashkalojë ndjenjat njerëzore që përfshihen në vendimmarrje. Në rastin e përdorimit të tepruar të forcës, për shembull, nuk mjafton që punonjësve të policisë t'u thuhet se 'duhet të kontrollojnë veten'. Atyre u duhet shpjeguar se "në situata të caktuara adrenalina shtohet dhe efekti i adrenalinës të shtyn që të vazhdosh ta godasësh një të dyshuar edhe mbasi e ke vendosur në pranga. Pikërisht sepse është normale që të ndihesh në këtë mënyrë, kur të vijë momenti duhet ta dish që ndjenjat do të jenë të tilla dhe në mënyrë që të kontrollosh emocionet duhet të marrësh frymë thellë, të përdorësh të menduarit sa më racional, të përpunosh situatën dhe të reagosh në mënyrë të ekuilibruar".

Dhënia e informacionit të duhur në një shkallë të tillë njohjeje i jep punonjësve të policisë formimin dhe përgatitjen e duhur për të përballuar dilemat dhe situatat e pashmangshme me të cilat do të ndeshen gjatë ushtrimit të detyrës në të gjithë karrierën e tyre.

Nga ana tjetër, edhe drejtuesit e policisë duhet të trajnohen që të njohin dhe t'i japin rëndësinë që i takon faktorit njerëzor dhe jo të nisen me mendimin se punonjësit e policisë funksionojnë si të ishin robotë. Duke njohur këto dimensione të karakteristikave njerëzore drejtuesit e policisë do të jenë në gjendje të komunikojnë më mirë edhe me publikun në lidhje me performancën e punonjësve të policisë.

Edhe pse drejtimi i policisë ka gjithmonë një dimension politik, drejtuesit e policisë duhet ta bëjnë të qartë se përveç publikut ata duhet t'i shërbejnë edhe një komuniteti më të vogël që janë vetë punonjësit e policisë.




Trajnimi i nëpërmjet identifikimit dhe zgjidhjes së dilemave etike

Një model efikas i trajnimit të etikës është përdorimi i dilemave të punonjësve të policisë si instrument trajnimi. Ky model trajnimi përfshin integrimin e problemeve me të cilat ndeshen punonjësit e policisë në një diskutim formal mbi etikën.

Përveç komunikimit të një sërë normash ligjore, formale, apo filozofike, trainimi i etikës duhet të fokusohet në përfshirjen në ushtrime praktike, të cilat të synojnë përvetësimin dhe përforsimin e sjelljes së dëshiruar brenda organizatës. Përmbajtja e këtyre trajnimeve konsiston në përshtatjen e një koncepti të caktuar ligjor, filozofik apo formal dhe diskutimi në mënyrë hipotetike i atij koncepti nëpërmjet dilemave etike.

Shembuj të dilemave etike mund të merren nga gazetatat, revistat apo botime të tjera të fushës. Gama e tematikës mund të përfshijë çështje si korrupsioni, favorët, ryshfeti, besnikëria ndaj kolegëve dhe raportimi i sjelljeve të gabuara, operacionet e fshehta, përdorimi i informatorëve, gjykimi, përdorimi i forcës, brutaliteti, marrëdhëniet seksuale gjatë detyrës, etj. Por duke qenë se kontekstet dhe rrethanat në të cilat mund të shfaqen dilemat etike shpesh janë specifike, vetë punonjësit e policisë mund të identifikojnë aspekte të etikës që i shqetësojnë ata. Kështu që është e rëndësishme që të diskutohen përvojat e vetë punonjësve të policisë që marrin pjesë në trajnim.

Pas prezantimit dhe diskutimit të materialeve teorike mbi etikën, kodin e etikës, vlerat morale të sistemit, etj., trajnuesi i kërkon secilit nga pjesëmarrësit të shkruajë rastin e një dileme etike me të cilën ata janë ballafaquar. Rasti duhet të jetë sa më konkret dhe jo përshkrim i një dileme të përgjithshme etike. Diskutimi me punonjësit e policisë i dilemave etike me të cilat ata janë ndeshur nuk është e njëjta gjë si diskutimi mbi dilemat etike të policimit në përgjithësi.



- Në përgjithësi dilema etike përkufizohet si një situatë në të cilën punonjësi i policisë

Nuk e di se cili është veprimi i drejtë që duhet të kryejë.

E ka të vështirë të kryejë atë që është veprimi i drejtë.

Është i tunduar të bëjë zgjedhjen e gabuar.

- Disa nga kategoritë me të shpeshta të dilemave etike janë.

Gjykimi
(ligjshmëria e vendimit)

Besnikëria

Detyra
(shërbimi i kryer)

Ndershmëria

Favoret dhe korrupsioni

Por identifikimi i kategorive të dilemave etike dhe renditja e tyre sipas rëndësisë është një ushtrim që kryhet vazhdimisht dhe gjatë trajnimit mund të rezultojë që të identifikohen dhe kategori të tjera.



Gjykimi (ligjshmëria)

Gjykimi mund të përkufizohet si kompetenca për të bërë një zgjedhje. Natyrshëm, të gjitha dilemat etike përfshijnë situatat ku punonjësit të policisë i duhet të bëjnë një zgjedhje, si për shembull të pranojnë apo të refuzojnë një ryshfet. Megjithatë diskutimi mbi gjykimin përfshin situata kur të dy zgjedhjet mund të jenë të drejta. Situata në të cilat një punonjës policie ka të drejtën e gjyimit, si për shembull për të këshilluar apo vendosur një gjobë, në përgjithësi nuk konsiderohen si dilema etike.

Shpesh punonjësit e policisë kanë paqartësi mbi rregullat që përcaktojnë se cili gjykim është i drejtë. Pra, çështja nuk qëndron gjithmonë tek ndarja e një gjykimi të drejtë nga një gjykim i padrejtë, por tek fakti se cili gjykim është më i drejti.

Diskutimet në lidhje me dilemat gjatë gjyimit janë mjaft të nevojshme, pasi ndihmojnë në identifikimin e kriterëve që punonjësit e policisë i cilësojnë si etike si dhe të kriterëve që gjejnë mbështetje më të madhe. Ky diskutim është i rëndësishëm për arsye se policia gjithmonë do të përdorë të drejtën e gjyimit gjatë zbatimit të ligjit.

Më poshtë jepen disa situata në të cilat punonjësit e policisë hasin dilema në ushtrimin e kompetencës për të gjykuar.



Dilema: Rrethana të vështira

Një qytetar njofton policinë se një fqinj i tij po ndërhyr në rrjetin elektrik për të rilidhur energjinë, të cilën ia kanë ndërprerë për arsye të mospagesës së faturës së energjisë. Një punonjës policie caktohet të shkojë për të verifikuar dhe konstaton se qytetari që ka shkelur ligjin jeton në kushte shumë të vështira. Banesa është e vjetër dhe e ftohtë dhe nëna e tij, më të cilën jeton, është e sëmurë rëndë. Në një situatë të tillë shkelësi i ligjit duket se ka vepruar i detyruar nga rrethanat e vështira në të cilat ndodhet. Kjo situatë e vendos punonjësën e policisë në një përplasje të brendshme ndërmjet mëshirës që ndjen për qytetarët dhe zbatimit të ligjit.



Dilema: Zbatimi me rreptësi i ligjit

Një punonjës policie ndalon për kontroll një makinë dhe konstaton se përdoruesja e mjetit ka pirë alkool, ndërkohë që në automjet ka dhe vajzën e saj të mitur. Kjo situatë e vendos punonjësën e policisë përpara një sërë dilemash. Ta arrestojë përdoruesen e automjetit dhe ta shoqërojë në stacionin e policisë, ndërkohë që të kërkojë që dikush tjetër të kujdeset për vajzën e mitur, apo ta lejojë të shkojë. Gruaja nuk po përpiqet që t'i ofrojë para në këmbim dhe tregohet bashkëpunuese. Kjo situatë është e qartë nga ana ligjore, por gjithsesi punonjësi i policisë gjendet në dilemë, pasi mendon se zbatimi i ligjit me rreptësi mund të mos i shërbejë qëllimit të drejtësisë. Disa punonjës policie mund të jenë shumë të qartë për kriteret që i udhëheqin në gjykimin e tyre, të tjerë mund të jenë më pak të sigurt mbi rolin etik të policisë.



Dilema: Situatë e paqartë ligjore

Në përgjigje të një telefonate për dhunë në familje një patrullë e përbërë nga dy punonjës policie dërgohet për verifikim. Punonjësit e policisë ballafaqohen me një situatë ku një çift i divorcuar ndan të njëjtën banesë dhe kanë një djalë të vogël. Gruaja nuk punon dhe jeton me të ardhurat që ish bashkëshorti i paguan për mbajtjen e fëmijës. Burri ka humbur vendin e punës pak kohë më parë dhe nuk ka mundësi të paguajë, ndërkohë që angazhohet se do të gjejë një mënyrë që t'ia japë paratë shumë shpejt. Gruaja pretendon se ish bashkëshorti i ka thënë dhe më parë se do të paguajë por nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe debatet e tyre kanë përfunduar me tone të larta.

Punonjësitet policisë konstatojnë se nuk është përdorur dhunë, por gruaja insiston se mospagesa në kohë i ka shkaktuar vështirësi jetese. Punonjësit e policisë janë konfuzë për mënyrën se si ta zgjidhin situatën. Dilema këtu qëndron në faktin se punonjësit e policisë duan ta zgjidhin situatën, por nuk dinë se cila do të ishte zgjidhja më etike. Situata përkeqësohet nga fakti se, edhe pse deri në atë moment nuk duket të ketë pasur shenja dhune, ata nuk mund të parashikojnë rrjedhën që mund të marrin gjërat më pas.

Janë të shpeshta situatat ku punonjësit e policisë përfshihen në raste të konflikteve familjare ku ka një problem real, por punonjësit e policisë e kanë të vështirë të përcaktojnë rrugën që duhet të ndjekin për të marrë një vendim etik.



Dilema: Shkelje nga një punonjës policie

Gjatë kohës që kryen një punë të dytë si roje sigurie në një lokal nate një punonjësi policie i duhet të ndërhyjë për të zgjidhur një grindje. Pasi reagon, ai konstaton se njëri nga personat e përfshirë në grindje është një punonjës policie, i cili është i dehur dhe nuk bindet që të largohet nga lokali. Personi tjetër pretendon se është sulmuar, por nuk e di se personi i dehur është punonjës policie.

Dilema që lind është gjykimi i një rasti ku përfshihet një marrëdhënie profesionale apo personale. Në mënyrë tipike, raste të tilla punonjësve të policisë u lindin me kolegë që gjenden në shkelje të ndryshme si drejtimi i automjetit nën efektin e alkoolit apo shkelje të ndryshme të rregullave të qarkullimit rrugor.



Detyra (shërbimi)

Detyra përfshin dy lloje kryesore dilemash. Dilema e parë lidhet me detyrën e një punonjësi policie për t'i dhënë zgjidhje një situatë të caktuar. Për shembull, në rastin e një mosmarrëveshjeje familjare, kur punonjësi i policisë konstaton se nuk është kryer ndonjë shkelje e ligjit, cila është detyra e tij? A duhet ta zgjidhë situatën përpara se ajo të përshkallëzohet deri në kryerjen e një krimi?

Po kështu, ka punonjës policie të cilët besojnë se e kanë për detyrë të mbrojnë më të dobët dhe të varfrit, por të tjerë nuk e ndiejnë një detyrim të tillë. Ballafaqimi në diskutime të tilla nxjerr në pah dallimet e opinioneve që janë thelbësore për mënyrën se si punonjësit e policisë e shohin rolin e tyre në komunitet. Edhe kjo është një çështje etike.

Dilema e dytë është me e drejtpërdrejtë. Punonjësi i policisë e di se detyra kërkon që të ndër marrë një veprim të caktuar por mendon se një veprim i tillë është i papërshtatshëm ose e konsideron si humbje kohe dhe heziton të ndër marrë veprimin e duhur.



Dilema: Anashkalim/Indiference

Është ora 10:30 e mëngjes dhe një punonjës policie po kthehet në komisariat për të mbyllur turnin kur ndesh në një bllokim trafiku. Duke iu afruar radhës së makinave ai konstaton se një automjet është përplasur me bordurën. A duhet të ndalojë dhe të ndihmojë për normalizimin e trafikut apo të vazhdojë rrugën për në komisariat?

Në praktikë jo të gjithë punonjësit e policisë e shohin detyrën në mënyrë të njëjtë. Për të kapërcyer situatën kur raste të tilla të ngelen në nivelin e shkëmbimit të opinioneve të ndryshme, trajneri i etikës duhet të aplikojë zgjidhjen brenda kuadrit etik. Analizimi i dilemave të tilla i ndihmon punonjësit e policisë që të mësojnë se, megjithëse disa qëndrime mund të konsiderohen si të justifikueshme dhe të ligjshme, ato mund të mos gjejnë mbështetje, nëse përkufizohen nga këndvështrimi i detyrës dhe shërbimit.



Ndershmëria

Në kategorinë e dilemave që lidhen me ndershmërinë, dilemat që shfaqen tek punonjësit e policisë janë përdorimi i profesionit për qëllime fitimi, shkeljet individuale apo situata që lidhen me arrestimet.



Dilema: Përvetësimi i sendeve me vlerë

Dy punonjës policie reagojnë ndaj një rasti krimi ku një i dyshuar si trafikant narkotikësh gjendet i shtrirë në një rrugicë dytësore i qëlluar me armë zjarri. Rrugica është e pandriçuar mirë dhe në skenën e krimit nuk ndodhet njeri tjetër. Gjatë kontrollit në xhepat e viktimës policët gjejnë një shumë parash prej rreth 10,000 Euro. Njëri prej tyre thotë se duhet t'i mbajnë për vete paratë dhe t'i ndajnë mes tyre.

Diskutimi dhe reflektimi mbi sjelljen etike në këtë rast mund të kryhet duke filluar me dilemën nëse shuma në fjalë do të ishte 20 Euro. Kjo bën të mundur të reflektohet nëse është shuma e përfshirë apo veprimi i kryer të cilat duhet të përcaktojnë thelbin etik të sjelljes.



Dilema: Gabim personal

Gjatë patrullimit me një automjet të policisë një punonjës perplasat me një bordurë dhe e dëmton automjetin. Në vendngjarje nuk ka njeri tjetër dhe për të shmatur përgjegjësinë punonjësi i policisë që kreu aksidentin mendon të raportojë se automjeti u dëmtua gjatë kohës kur ishte i parkuar nga një automjet tjetër i cili ishte larguar nga vendngjarja.

Në këtë dilemë punonjësi i policisë përpiket të mbulojë veprimin e tij duke gënjyer apo duke mos dashur të përballet me gabimin e kryer.



Besnikëria

Në situatat ku përfshihet besnikëria punonjësit e policisë duhet të vendosin se çfarë duhet të bëjnë kur ballafaqohen me gabime të kryera nga punonjës të tjerë.

Gama e dilemave të tyre në këtë kategori shtrihet nga të qenit dëshmitarë të gabimeve relativisht të vogla, si keqpërdorimi i kohës së punës, deri tek shkelje të rënda si marrja e ryshfetit, shpërdorimi i burimeve të policisë apo abuzimi me të drejtat themelore të shtetasve në dhomat e paraburgimit.

Çfarë duhet të bëjnë punonjësit e policisë kur janë dëshmitarë të përdorimit të forcës së tepruar nga kolegët e tyre? Edhe pse mund të mos jenë dakord me aktin, a duhet t'u qëndrojnë besnikë kolegëve apo të denoncojnë shkeljet e tyre? Një kategori tjetër dileme përbëhet nga dyshimet që kanë punonjës policisë se kolegë të tyre mund të kenë kryer një krim.



Dilema: Më mbulo

Një punonjës policie i përgjigjet thirrjes për të ndërhyrë në një dyqan bizhuterish që është grabitur. Punonjësi i cili ka arritur i pari në skenën e ngjarjes këmbëngul se duhet përpiluar një listë e objekteve të vjedhura. Pas disa ditësh kolegu i tij, që kishte arritur pak më vonë në skenën e ngjarjes, konstaton se punonjësi i policisë ka vënë një varëse, të cilën ai dyshon se është nga sendet e dyqanit të vjedhur. Punonjësi i policisë i thotë kolegut se kishte blerë varësen me çmim të lirë me ofertë. Çfarë duhet të bëjë ai në këtë rast?



Privilegjet dhe ryshfeti

Kur diskutohet për etikën, favorët dhe ryshfeti janë të pashmangshme. Privilegjet dhe ryshfeti perceptohen në përgjithësi nga publiku, por jo vetëm, si një problem i pandashëm nga policimi. Edhe pse duken njësoj, ka një dallim ndërmjet tyre. Privilegjet që punonjësit e policisë përfitojnë (si ushqim, pije apo karburant falas, shërbime falas si larje automjeti, etj.) janë shpesh të lidhura me kulturën që mbizotëron në marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe publikut. Ryshfeti dhe dhuratat, nga ana tjetër, u jepen punonjësve të policisë në këmbim të një veprimi të caktuar.

Si marrja e privilegjeve ashtu edhe e ryshfetit apo dhuratave janë çështje problematike për punonjësit e policisë dhe organizatën policore.



Dilema: Refuzimi i privilegjeve

Një punonjës policie është duke patrulluar në zonën e tij. Për të shmangur çdo mundësi përfshirje në marrëdhënie që konsiderohen të pahijshme polici preferon të shmangë konsumimin e pijeve dhe ushqimit në zonën ku shërben. Nga përvoja ai ka mësuar se njerëzit gjithmonë presin diçka në këmbim për çdo privilegj. Për shkak se bën shumë vapë polici ndalon në një lokal për të blerë një shishe ujë. Shitësi refuzon të marrë paratë, ndërsa polici insiston se do që të paguajë për ujin. Shitësi mundohet që ta bindë duke i thënë se ai nuk ka pse hiqet sikur nuk do ta marrë falas ujin, pasi edhe policët e tjerë e pranojnë një gjë të tillë. Shitësi më në fund i pranon paratë, por e ironizon duke i thënë se do to thotë kolegëve të tij se sa i ndershëm është. Cili është reagimi i duhur në këtë situatë?



Dilema: Refuzimi i ryshfetit

Një punonjës i ri policie i sapo caktuar në patrullën e qarkullimit rrugor lajmërohet të shkojë të administrojë një situatë aksidenti të

lehtë ku janë përfshirë dy automjete. Pas përfundimit të procedurës për përcaktimin e përgjegjësive në aksident punonjësi i policisë lajmëron për dërgimin e dy karrotrecëve për të dërguar automjetet për riparim.

Me të mbërritur, shoferi i karrotrecit i jep policit kartëvizitën dhe 1,000 lekë të reja, dhe i premtun se do t'i paguajë këtë shumë për çdo rast autotransporti të automjeteve të aksidentuara, nëse i telefonon atij për të kryer shërbimin. Ai i thotë se ka marrëveshje të tillë me disa kolegë të tij të cilët kanë mbetur mjaft të kënaqur. Cili është reagimi i duhur në këtë situatë?

Ky kapitull e vuri theksin tek nevoja e lidhjes së trajnimit për etikën me përvojat konkrete të punonjësve të policisë në mënyrë që të jetë i vlefshëm dhe të japë rezultate.

Përveç komunikimit të një sërë normash ligjore, formale, apo filozofike, trainimi i etikës duhet të përfshijë ushtrime praktike që synojnë përvetësimin dhe përforsimin e sjelljes së dëshiruar brenda organizatës.

Situatat hipotetike mund të shërbejnë për të ndihmuar në identifikimin dhe kategorizimin e dilemave etike, por dilemat me të cilat punonjësit e policisë ndeshen në punën e tyre të përditshme ofrojnë një bazë të fuqishme për të filluar diskutimin në lidhje me një sërë çështjesh etike.

Aplikimi i tyre në trajnimet në praktikë mund të sjellë si rezultat identifikimin e kategorive apo grupimeve të ndryshme të dilemave, të cilat janë specifike për kontekste të caktuara. Përfitimi nga kjo qasje është se i vendos punonjësit e policisë në situata pothuajse reale dhe i jep atyre instrumentet për të identifikuar dhe zgjidhur dilemat.

Krijimi i një kuadri praktik etik nuk mjaftohet me njohjen dhe shmangien e këtyre dilemave. Kuadri i qëndrueshëm etik krijohet nga mënyra se si reagojnë punonjësit e policisë ndaj paqartësisë, pasigurisë dhe kompromisit që prodhojnë situata të caktuara, dhe në vendimet që ata marrin.

Njohja e dilemave të përbashkëta, njohja e sistemit të etikës dhe zgjidhja e dilemave duke aplikuar kuadrin etik u japin punonjësve të policisë bazat e duhura për të zgjidhur dilemat me të cilat ndeshen, qofshin ato të thjeshta apo më të ndërlikuara.

Probleme, justifikime dhe mënyra alternative të menduari për zgjidhjen e dilemave etike

Një nga rregullat themelore të policimit etik dhe element bazë i integritetit është detyrimi i punonjësve për të raportuar shkeljet të ndryshme të kryera nga kolegët gjatë dhe për shkak të detyrës. Megjithatë, punonjësit e policisë hasin vështirësi në zbatimin në praktikë të këtij detyrimi, dhe një nga pengesat për zbatimin e këtij rregulli është kultura e heshtjes, e cila përbën një nga elementët e kulturës policore.

Në këtë kapitull jepen disa skenarë, të cilët përmbajnë justifikime që shpesh përdoren nga punonjës police kur duan të shmangin të flasin për një sjellje të caktuar dhe i frenojnë ata të veprojnë në përputhje me vlerat themelore apo të ngrënë zërin për gjëra të padrejta.

Skenarët shoqërohen me alternativa reagimi ndaj dilemave të ndryshme me të cilat punonjësit e policisë mund të ndeshen dhe parashtrojnë mënyra të menduari dhe shprehje të cilat mund të përdoren për të filluar një diskutim apo folur për çështje etike. Po kështu jepen dhe sugjerime për fjali që mund të përdoren kur punonjësi i policisë vendos të ballafaqohet me veprimet e dikujt tjetër. Skenarët mund të shërbejnë për qëllime trajnimi, por mund edhe të përvetësohen në mënyrë vetjake nga punonjës të caktuar policie për të trajtuar probleme etike kur ata ndeshen me to. Disa skenarë tregojnë se si mund të reagojë

zyrtarisht me anë të raportimit për rastet kur duket qartë se ka shkelje të rregullores sipas së cilës duhet raportuar tek organet përkatëse.

Probleme të shpeshta etike	Justifikime që përdoren për të mos folur	Mënyra alternative të menduari për të nxitur reagimin	Një mundësi korrekte reagimi
<p>Një koleg të kërkon të falsifikosh një raport të dorëzimit të turnit.</p>	<p>Nuk ia vlen të hap telashe duke tërhequr vëmendjen për një çështje të tillë.</p> <p>Ndoshta bëhet fjalë për një rast të vetëm dhe nuk ja vlen të tregohem i ngurtë.</p> <p>Më mirë të pranoj se sa të bëhem shkak që kolegut t'i krijohen telashe.</p>	<p>Duhet që të flas sepse me sa shoh nuk e paska idenë se sa e pa përshtatshme është kjo gjë.</p> <p>Është konflikt i pastër interesi dhe duhet të flas përpara se të bëhet problem.</p> <p>Ky koleg po përfiton nga situata në të cilën ndodhet ai person dhe është duke keqpërdorur kompetencën.</p>	<p>Kjo situatë po bëhet tepër e koklavitur. A i ke menduar pasojat që mund të kesh?</p>
<p>Bëhesh dëshmitar i një sjellje jo-etike ndaj një qytetari.</p>	<p>Nuk ka faj, gjithë ky stres...</p> <p>Ai ka më shumë përvojë se unë dhe e di se cilat metoda funksionojnë më mirë me njerëzit.</p>	<p>Dihet se është më mirë për policinë të sillësh në mënyrë sa më etike edhe kur kjo duket e vështirë për t'u bërë. Është pjesë e punës.</p>	<p>Kjo punë do shumë durim. Është më mirë të jemi të qetë dhe të mendojmë se ai njeri do të na duhet në anën tonë ndonjë ditë.</p>

Probleme të shpeshta etike	Justifikime që përdoren për të mos folur	Mënyra alternative të menduari për të nxitur reagimin	Një mundësi korrekte reagimi
<p>Asiston në keqpërdorim të automjetit të policisë.</p>	<p>Më mirë të bëj sikur nuk pashë gjë.</p> <p>Epo nuk ka problem. Pajisjet vjetërsohen dhe prishen kështu që do të zëvendësohen dikur...</p>	<p>Nuk ndihem mirë kur shoh gjëra të tilla. Gjërat që kemi duhet t'i mirëmbajmë.</p> <p>Nuk kam hyrë në këtë punë që të shoh gjëra të tilla dhe të mos reagoj.</p> <p>Keqpërdorimi i pajisjeve na prek të gjithëve, kështu që duhet të reagoj. Me gjithë ato gjëra që na mungojnë këto që kemi duhet t'i ruajmë.</p>	<p>Vërtet të duket se është gjë e mirë kjo që bëre? Mendoj se është kundër rregullave dhe nuk është korrekte, pasi përgjegjësia mund t'i ngelet atyre të turnit tjetër.</p>
<p>Mëson për kolegë që pranojnë privilegje apo dhurata.</p>	<p>Nuk i bën dëm askujt.</p> <p>Kështu mbahen marrëdhëniet me njerëzit. Nuk dua t'i fyej duke i thënë se kanë bërë keq.</p> <p>Në këtë lokal gjithmonë i kanë qerasur policët.</p>	<p>Çfarë do si shpërblim për qerasjen? Me siguri do të gjendemi në konflikt interesi.</p> <p>Me kalimin e kohës do të komprometohet me gjëra më të mëdha.</p> <p>Po bëra sikur nuk kam parë gjë do të komprometoj edhe punën time.</p>	<p>Mendoj se është më mirë ta refuzojmë, pasi biem në konflikt interesi dhe do ta kemi më të vështirë më vonë. Kush e di se çfarë mund të na kërkojë.</p>

Probleme të shpeshta etike	Justifikime që përdoren për të mos folur	Mënyra alternative të menduari për të nxitur reagimin	Një mundësi korrekte reagimi
<p>Mëson për një shkelje të një kolegu të cilën eprorët nuk e kanë konstatuar ose që mund ta kenë mbuluar me qëllim.</p>	<p>Do të jetë më e lehtë nëse bëj sikur nuk kam mësuar gjë.</p> <p>Nuk kam zgjidhje tjetër. Nëse nuk bëj sikur nuk di gjë, do të kem problem në marrëdhëniet me kolegët.</p> <p>Po raportova, ata të Drejtorisë së Standardeve do të na fusin të gjithëve në sitë.</p>	<p>Nuk kam pse rrezikoj reputacionin tim se dikush bën zgjedhjen e gabuar.</p> <p>Dikush duhet të flasë këtu.. Ky person i ka bërë llogaritë gabim, nëse mendon se do të pranoj një situatë të tillë.</p> <p>Kjo është një gjë që komprometon tërë policinë, ndaj nuk mund të anashkalohet.</p>	<p>Më fal, por nuk mund të kthej kokën nga ana tjetër për një gjë të tillë. Nuk dua të rrezikoj vendin e punës.</p>
<p>Dyshon se kolegë ndikohen nga paragjykime ndaj një grupi pakice.</p>	<p>Mirë e kanë. Të gjithëve u ka ardhur në majtë të hundës me ta, vetëm telashe i sjellin qytetit.</p> <p>Sapo kam filluar punë dhe ndoshta është herët të ndërhyj për gjëra të tilla.</p>	<p>Policia duhet të japë shembullin e vet në trajtimin e drejtë dhe pa paragjykime të njerëzve.</p> <p>Është përgjegjësia ime të reagoj ndaj kësaj që po shoh, sepse kjo gjë duhet të ndryshojë.</p> <p>Duhet që dikush të fillojë të silllet në mënyrë pozitive, përndryshe ka për të vazhduar kështu dhe mund të bëhet edhe më keq.</p>	<p>Mendoj se është më mirë të përpiqemi të krijojmë një marrëdhënie të mirë sesa t'i paragjykojmë të gjithë për shkak të disave.</p>

Probleme të shpeshta etike	Justifikime që përdoren për të mos folur	Mënyra alternative të menduari për të nxitur reagimin	Një mundësi korrekte reagimi
<p>Mëson për kolegë që abuzojnë me përdorimin e lëndëve narkotikëve/alkoolit.</p>	<p>Nuk mund të jem përgjegjës për zgjedhjet e të tjerëve.</p> <p>Nuk është puna ime, ndaj më mirë të mos përzihem.</p>	<p>Kjo është një gjë serioze, sepse janë dhe të armatosur.</p> <p>Duhet të flas me dikë, sepse ata nuk mund të vazhdojnë kështu.</p> <p>Mbase mund të kenë nevojë për ndihmë dhe nuk bën të hiqem sikur nuk di gjë.</p>	<p>Me duket se keni nevojë për ndihmë dhe duhet të flisni me dikë për të zgjidhur këtë problem.</p>
<p>Mëson se kolegu nënvleftëson apo deformon një hetim.</p>	<p>Në fakt, ndonjëherë edhe i duhet rënë shkurt për ta mbaruar punë.</p> <p>Puna nuk bëhet asnjëherë, nëse nuk i shmangesh pak rregullave.</p> <p>Ata që kanë vënë këto rregulla duket që nuk ia kanë idenë kësaj pune.</p>	<p>Mbase ky person nuk i ka të qarta arsyet se përse duhen rregullat, prandaj duhet t'ia tregoj.</p> <p>Nuk kam hyrë në këtë profesion që të shoh të tjerët që bëjnë çfarë të duan me ligjin.</p> <p>A nuk bëhemi po aq të këqij sa dhe kriminelët, nëse i deformojmë ligjet? Kjo mënyrë nuk më përshtatet.</p>	<p>Duhet t'i përmbahemi rregullave të policisë. Po vazhduat në këtë rrugë, mund të përfundojmë edhe me humbjen e vendit të punës.</p>

Probleme të shpeshta etike	Justifikime që përdoren për të mos folur	Mënyra alternative të menduari për të nxitur reagimin	Një mundësi korrekte reagimi
<p>Bëhesh dëshmitar i sjelljes së vrazhdë ndaj një qytetari</p>	<p>Në fakt ia bëri borxh me atë sjellje, ndaj e meritonte.</p> <p>Mbase ka ndonjë hall dhe nuk i mbajnë nervat.</p> <p>Nganjëherë policia duhet ta tregojë se në situata të caktuara duhet të jetë kategorike.</p>	<p>Nëse nuk i japim fund kësaj mënyre, mund të lëndojmë rëndë ndonjërin.</p> <p>Nëse nuk ndërhyj që kjo të ndalojë, situata mund të përkeqësohet dhe mund të humbasë dhe punën.</p> <p>Kjo nuk ishte sjellje kategorike; ishte sjellje agresive.</p>	<p>Mendoj se u tregove mjaft i vrazhdë me atë person. Kjo mënyrë me siguri do të na prishë imazhin të gjithëve.</p>

Përfundime

Tradicionalisht, kurrikulat e trajnimit policor janë parashikuar t'u japin rekrutëve të rinj të policisë bazën e nevojshme të formimit për t'u bërë efektivë të aftë në ruajtjen e rendit publik. Por, ndërkohë që tradicionalisht fokusi i policimit ka qenë tek ruajtja e rendit dhe zbulimi i krimeve, sot shërbimet e policisë përballen me sfidën për t'i përgjigjur kërkesave të reja. Nga oficerët e policisë pritet që të kryejnë funksione shtesë që lidhen me policimin në komunitet, shërbimet ndaj publikut dhe parandalimin e krimit.

Përmbushja me efektivitet e këtyre funksioneve përfshin garantimin e mbështetjes së publikut duke siguruar transparencë në veprimet dhe detyrat e policisë, duke demonstruar integritet profesional, parandaluar korrupsionin dhe duke iu përshtatur ndryshimeve të vazhdueshme.

Për pasojë shërbimi policor duhet t'i kushtojë vëmendje më të madhe integritetit profesional dhe të rivlerësojë punën e vet në përputhje me nevojat e publikut. Këto ndryshime të rëndësishme në shoqëri dhe në policim kanë sjellë nevojën që shërbimet policore të bëjnë ndryshime në organizimin e punës dhe një nga aspektet më të rëndësishme të këtij riorganizimi është krijimi i një kulture të re policore.

Policia simbolizon praninë e dukshme të shtetit në shoqëri dhe shihet nga publiku si zbatuesja kryesore e ligjit. Por elementet e ndryshëm, pozitivë dhe negativë, të kulturës policore ndikojnë në mënyrën se si e shohin dhe e zbatojnë ligjin punonjësit e policisë. Nëpërmjet refuzimit të sjelljes jo etike dhe nëpërmjet kultivimit të vlerave në vendimmarrje punonjësit e policisë mund të kontribuojnë në ndryshimin për mirë të kulturës policore.

Përkundrajt këtij sfondi, ky manual jep disa orientime dhe standarde për të ndërtuar kurrikulat bazë për të përmirësuar trajnimin e etikës në Policinë e Shtetit me qëllim forcimin e kulturës së integritetit.

Manuali reflekton parimet e policimit demokratik sipas të cilit policia i shërben në radhë të parë publikut më shumë se sa shtetit. Manuali nisat nga premiset se veprimet dhe vendimmarrja e përditshme e punonjësit të policisë bazohen tek vlerat, etika dhe gjykimi i drejtë, të cilat krijohen dhe konsolidohen nëpërmjet dijeve dhe njohurive. Ky manual përbën vetëm një hyrje në trajnimin për etikën duke prekur disa nga aspektet

kyçe të saj. Manuali synon të japë një pamje të nevojës për përfshirjen e etikës në policim dhe mënyrës se si punonjësit e policisë mund dhe duhet të trajtojnë çështjet etike gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

Nga ana tjetër, me gjithë konsensusin e gjerë mbi etikën policore, trajnerët duhet të marrin në konsideratë pikëpamjet e ndryshme të punonjësve të policisë për mënyrën se mund të trajtohen çështje specifike.

Një nga hapat e duhur drejt vendimmarrjes etike është të kuptuarit e qasjeve të ndryshme dhe aftësia për t'u shpjeguar të tjerëve vendimin e marrë.

Trainimi i etikës policore nuk është të mësuarit e moralit por diskutimi, pranimi dhe zgjidhja e problemeve që lidhen me dilemat që shfaqen gjatë ushtrimit të profesionit.

Etika nuk mund të konsiderohet si një dekor i thjeshtë teknik në trajnimin e policisë. Ajo duhet të jetë pjesë integrale e të gjithë trajnimit policor dhe duhet të përshkojë kulturën organizative të policisë.

Punonjësit e policisë, si të gjithë punonjësit e administratës publike, nuk duhet ta shohin etikën si diçka alternative, por si një pjesë të detyrueshme dhe një standard themelor të punës së tyre.

Për më tepër, policimi etik duhet të integrohet në kuadrin e përgjithshëm të vendimmarrjes në nivel strategjik, operacional dhe taktik në mënyrë që të mos ngelet në kufijtë e deklaratave simbolike. Për këtë arsye mosdhënia e trajnimit të duhur mbi etikën policore mund të konsiderohet si neglizhencë dhe dështim organizativ.

Është detyrë e drejtuesve të policisë dhe institucioneve akademike policore që të japin kontributin e tyre në përmirësimin e trajnimit të etikës. Për shkak të zhvillimeve dhe ndryshimeve në fushën e policimit, trainimi i etikës duhet të jetë fleksibël dhe i hapur ndaj ndryshimeve.

Krijimi i partneritetit me qarqet universitare dhe akademike është një mënyrë që mund ta bëjë më të efektshëm trajnimin për etikën, pasi krijon mundësinë për një trajtim më të pavarur të dilemave dhe mund të jetë përfitues si për policinë ashtu edhe për komunitetin dhe akademikët.

Përvojat me trajnimin e etikës dhe dilemat etike të sjella gjatë trajnimeve duhet të përfshihen në nivel akademik duke kontribuar kështu në pasurimin e literaturës vendore mbi etikën policore.

Referenca e lexim i mëtejshëm

Arjan Dyrmishi, Elona Dhembo, Gjergji Vurmo, Besiana Kuçi. Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri, Tiranë, IDM Albania 2014

Craig S. MacMillan, Why Ethics Demand Immediate Attention, The Police Chief 82 (December 2015): 22

Council of Europe Publishing, European Code of Police Ethics, Recommendation Rec(2001)10 adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 19 September 200

Ethics Training for Public Officials, OECD Anti-Corruption Network for Eastern Europe and Central Asia (ACN), March 2013

European Police College, Common Curriculum - Police Ethics & Prevention of Corruption

Good Practices in Basic Police Training – Curricula Aspects, SPMU Publication Series Vol.5, OSCE 2008

Guidebook on Democratic Policing, OSCE, Organization for Security and Co-operation in Europe, 24 January 2007

John P. Crank, Michael A. Caldero, Police ethics: The corruption of noble cause. Routledge, 2010.

Joycelyn M. Pollock and Ronald F. Becker, Ethics training using officers' dilemmas. FBI Law Enforcement Bulletin. 1996; 65(11):20-7.

Joycelyn M. Pollock. Ethical dilemmas and decisions in criminal justice. Nelson Education, 2014.

Karen Wagener, IACP Foundation: Police Foundation Ethics and Governance, The Police Chief 77 (April 2010): 10

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998

Rregullore e Policisë së Shtetit, Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë, Shtator 2015

- Pierre Aeppli (Ed), *Pakoja e instrumenteve mbi integritetin e policisë*, DCAF 2012
- Paulo Costa, Isaline Thorens, *Training Manual on Police Integrity*, DCAF 2015
- Roy R. Roberg, John P. Crank, and Jack Kuykendall. *Police & society*. Los Angeles, CA: Roxbury, 2000.
- Tag Gleason, *Ethics Training for Policem* *The Police Chief*, vol. 73, no. 11, November 2006
- Thomas J. Martinelli and Joseph A. Schafer, *Updating Ethics Training-Policing Privacy Series: Taking Race out of the Perception Equation*, *The Police Chief* 78 (January 2011): 18–22
- Thomas J. Martinelli, *Redefining the Police Ethics Paradigm, Unconstitutional Policing, Part 1*, *The Police Chief* 82 (September 2015): 72–77
- Steve Papenfuhs, *Ethical dilemmas cops face daily*, *Policeone*, April 2011
- United Nations *Handbook on Practical Anti-Corruption Measures for Prosecutors and Investigators*, Vienna, September 2004